



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” REKTORI

Departamenti i *Letërsisë dhe i Gazetarisë* në Fakultetin e Shkencave Humane në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” për nevojat e tij, për mbulimin e procesit mësimor për vitin akademik 2025-2026, semestri i II-të, shpall konkurs për personel akademik me kohë të pjesshme të kategorisë profesor i asociuar.

Kriteret e **përgjithshme e të veçanta** të konkurrimit për pozicionin e punës të kategorisë *profesor i asociuar*:

1. Të mbajë titullin profesor i asociuar (Prof.as.dr) në fushën e *Letërsisë*. (Titulli i lëshuar nga Institucionet e huaja të Arsimit të lartë dhe Institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit, duhet të jenë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
2. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet universitare (Ba dhe Master i Shkencave ose ekuivalente me të) në shkencë humane në fushën e *Letërsisë*; brenda ose jashtë vendit, (Diplomat e lëshuara nga Institucionet e huaja të Arsimit të lartë dhe Institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit, duhet të jenë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
3. Të ketë përvojë të dokumentuar dhe të jetë i angazhuar në fushën e mësimdhënies, por edhe të kërkimit shkencor;
4. Kandidati duhet të ketë të paktën 3(tre) vjet eksperiencë pune;
5. Kandidati duhet të jetë i specializuar në fushën e shkencës për letërsinë, teorive letrare dhe letërsisë bashkëkohore shqipe;
6. Parapëlqehet të ketë marrë pjesë në konferenca shkencore në fushat e kërkuara. Referimet dhe botimet të jenë në fushat e sipërpërmenduar;
7. Të jetë i/e gatshëm të përfshihet në mësimdhënie sipas orarit të përcaktuar nga drejtuesi i departamentit dhe sekretaria, pa kufizim kohor gjatë një dite mësimore.
8. Kandidati duhet të zotërojë të paktën një gjuhë të huaj të BE-së, (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht) të mbrojtur dhe të vërtetuar me dëshmi
9. Ndaj kandidatit të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna;
10. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata;
11. Të jetë i aftë për punë;
12. Leje nga punëdhënësi për ushtrimin e mësimdhënies në UE.;

Kandidatët **duhet të dorëzojnë** nga data **29.01.2026** deri **07.02.2026** këto dokumente:

1. Kërkesë me shkrim (Plotësimi i formularit të aplikimit)
2. Jetëshkrimi.
3. Kopje të diplomës dhe të listës së notave. (Diplomat e lëshuara nga Institucionet e huaja të Arsimit të lartë dhe Institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit, duhet të jenë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI**

4. Dokumentacionin shoqërues përkatës origjinal ose të noterizuar sipas plotësimit të kriterëve të shpallura etj.
5. Vërtetim punësimi nga punëdhënësi për eksperiencën e punës.
6. Vërtetim i gjendjes gjyqësore (Dëshmi penalteti)
7. Raporti i aftësisë në punë.
8. Fotokopje e letërnjoftimit.
9. Librezë shëndetësore.
10. Leje nga punëdhënësi për mësimdhënie në UE

Përveç konkurrimit me dosje aplikantët do t'i nënshtrohen *intervistës me gojë* në departament.

Dokumentacioni i kërkuar mund të dorëzohet në **rrugë postare 29.01.2026** deri **07.02.2026**.

Adresa postare:

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,
Rruga “Ismail Zyma”,
Aplikim në Fakultetin e Shkencave Humane
Departamenti i Letërsisë dhe Gazetarisë
Elbasan**